

Vendim nr. 169 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (G) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GEN TOTA

OBJEKTI: Detyrimi i Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes penale nr. 56280-00225-00-2019 të regjistrimit themeltar, datë 21.02.2019, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gen Tota ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 10-2018-193, datë 26.07.2018 të Gjykatës së Apelit Korçë, me të cilin ai është dënuar për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuara nga nenet 248/2 dhe 283 të Kodit Penal (KP) dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin me burgim. Kjo çështje është

regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 56280-00225-00-2019 të regjistrit themeltar, datë 21.02.2019.

2. Në datën 26.07.2022 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përsheptim, bazuar në nenin 12, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 55/2018*), me argumentin se megjithëse kanë kaluar 3 vjet e 6 muaj nga momenti i depozitimit të rekursit, nuk është caktuar ende data për shqyrtimin e tij dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga kjo gjykatë.

3. Në vijim, në datën 28.02.2023, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për informacion në Gjykatën e Lartë, me pretendimin se në datën 08.09.2022 përfaqësuesit ligjor të tij i është komunikuar nëpërmjet telefonit nga kjo gjykatë se rekursi hyn në kategorinë e çështjeve që duhen përsheptuar dhe së shpejti do të caktohej data e seancës, por një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

4. Me shkresën nr. 1408/1, datë 17.03.2023, Gjykata e Lartë i ka komunikuar kërkuesit se kërkesa e datës 26.07.2022 për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes është trajtuar nga relatori i çështjes M.B. dhe sipas vlerësimit të datës 07.10.2022 të këtij të fundit, çështja nuk hyn në kategorinë e çështjeve që gjykohen me përsheptim në Gjykatën e Lartë.

5. Me kërkesën e datës 02.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

6.1. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi megjithëse nga momenti i depozitimit të rekursit kanë kaluar më shumë se 4 vjet, çështja është ende në fazën e studimit dhe nuk është caktuar data për shqyrtimin e tij. Kërkuesi po vuan dënimin me burgim prej më shumë se 5 vjetësh, megjithëse në asnjë moment nuk ka pranuar fajësinë e tij.

6.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Korçë, gjithashtu, kanë caktuar masën e sigurimit “Arresti në burg” me vendimin nr. 105, datë 07.08.2016.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi, në thelb, ankohet për gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të rekursit të tij kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta, të cilat e kanë dënuar me burgim. Për rrjedhojë, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendime dhe, si i tillë, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i cili nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike efektive përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 05.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi në datën 28.02.2023 ka paraqitur kërkesë me shkrim në Gjykatën e Lartë për përshpejtimin e gjykimit të rekursit të tij, pasi megjithëse kanë kaluar 3 vjet e 6 muaj nga momenti i depozitimit të rekursit, nuk është caktuar ende data për shqyrtimin e tij. Kjo kërkesë është bazuar në nenin 12, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 55/2018. Në përgjigje të kësaj kërkesë, kancelari i Gjykatës së Lartë, me shkresën e datës 17.03.2023 e ka informuar se çështja e tij nuk hyn në kategorinë e çështjeve që gjykohen me përshpejtim në këtë gjykatë.

12. Nga sa më lart, Kolegji vëren se pavarësisht se kërkuesi ka paraqitur një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, mjeti ligjor i zgjedhur nuk është ai i parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë, nëpërmjet kancelarit të saj, e ka trajtuar kërkesën e tij për përshpejtim me shkresë me lëndë “*Kthim përgjigjeje*”, duke mos e konsideruar atë në llojin e atyre kërkesave për t'u trajtuar me vendimmarrje, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Prandaj, Kolegji vlerëson se legjislacioni procedural ka parashikuar këto të fundit si mjete ligjore, të cilat kërkuesi mund t'i ushtrojë për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Vetëm pas shterimit të tyre ai mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual.

13. Për sa i përket pretendimit tjetër për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Kolegji vlerëson se ai lidhet me shqyrtimin në themel të çështjes, i cili nuk ka përfunduar ende në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, kërkuesi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tij për cenimin e kësaj të drejte atyre gjykatave, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

14. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.